

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
PONARI 2E INVEST shpk**

Me qëllim të të funksionimit dhe të organizimit të shoqërisë **PONARI 2E INVEST** shpk, është hartuar ky Statut i përshtatur me kërkesat e Ligjit nr 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti, Vula

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është **PONARI 2E INVEST shpk** Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjithë regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.2 Shoqëria **PONARI 2E INVEST shpk** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 2

Ortaku

- 2.1 Është ortak i vetë i shoqërisë në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:
- Z. Skifer Ponari , i datëlindjes 03.03.1984 , vend banimi , Tiranë, nr personal I40303220Q, i cili zotëron 100 % të pjesëve të kuotave të shoqërisë ..

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë është në rrugën Alla , kopshti Zoologjik , pallati Pajtoni, shkalla 1, apartamenti 23 .
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja.


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

Në fushën e pasurive të paluajtshme, shitblerje pronash, menaxhim pasurish të luajtshme e të paluajtshme, ndërmjetësime në Qiradhënie-Qiramarrje pronash, Vlerësim pasurish. dhënie me qera ditore , Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile dhe publike, ndërtimeve të objekteve 1 katëshe dhe shumë katëshe, ndërtime veprash arti, ujësjellësash, rrugësh, ndërtime në godina shtetërore dhe private, restaurime etj, të lidhë marrëveshje me pronarë truall për ndërtim, marrëveshje me shoqëri të tjera për këto troje, etj , mirembajtje dhe pastrime të godinave private e shtetërore , shtëpive , ambiente të brendshme dhe të jashtme ,ndërmjetësime dhe përfaqësim kompanish të huaja dhe vendase për pjesëmarrje në tendera në fusha



të ndryshme , konsulencë financiare, juridike, bashkim dhe transferim kompanish apo ndërmarrje vendase apo të huaja, ofrim konsulencë dhe asistim të kompanive për rritjen e kapitalit dhe strukturave të tyre, nxitjen dhe gjetjen e oportuniteteve të ofertave publike, ofrim fizibilitetesh, kryerje dhe zbatim të studimeve të tregut për shkrije, blerje, konsolidim kompanish vendase dhe të huaja, blerje dhe menaxhim asetesh, duke i shërbyer në këtë rast tregut lokal, global dhe rajonal njëkohësisht,

Neni 6

Vula

- 6.1 Shoqëria ka vulën e saj identifikuese,specimenti i së cilës është në origjinal në faqen e fundit të këtij statuti.
- 6.2 Vula e shoqërisë mund të ndryshojë vetëm me vendimin të ortakut të vetëm.
- 6.3 Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria,pasi nënshkruhen sipas ligjit,vulosën me vulën e shoqërisë.

KREU II

KAPITALI, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 7

Kapitali

- 7.1. Kapitali aksionar i shoqërisë është 100.000 leke (njqindmije)dhe përbëhet nga 1 kuote . Kapitali i rregjistrimit është kontribut në para te ortakut të vetëm Z. Skifer Ponari ,
- 7.2. Pronësia mbi kapitalin ë shoqërisë është si më poshtë:
100% e kapitalit që përbëhet nga 1 kuotë në shumën 100.000 leke (njqindmije) zotërohen nga ortakut i vetem Z, Skifer Ponari


Neni 8

Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave.

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - b) Shitblerje
 - c) Trashëgimisë
 - c) Dhurimit
 - d) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
Çdo transferim i kuotave tek të tretëtbëhet me vendim të ortakut të vetëm,duke redaktuar dhe akt noterial për trasferimin e kuotave.

Neni 9

Rritja e kapitalit



- 9.1 Shoqëria mund të rrisë Kapitalin Themeltar në para ose në natyrë (pasuritë të luajttëshme apo të paluajttëshme) ose mund të zvogëlojë atë,por jo nën kufirin minimal që lejon ligji Nr.9901 Datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare"(pjesë për sh.p.k.)
- 9.2 Shtimi ose zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.
Dokumenti depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,e cila bën ndryshimet përkatëse

KREU III
ORGANET VENDIMARËSE DHE DREJTUESE
NENI 10

Organi Vendimarrës

Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme .
Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm,i cili është organi i vetëm vendimarrës i kësaj shoqërie.

- 10.1. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtëme:
- a. Përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë.
 - b. Ndryshimin e statusit.
 - c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.
 - ç. Emërimin dhe shkarkimin e likujtditorëve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar.
 - d. Përcaktimin e shpërblimit për personat e përmendur në pikat "c" dhe "ç" të kësaj pike.
 - dh. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave finaciare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë.
 - e. Miratimin e pasqyrave finaciare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë.
 - e. Zmadhim dhe zvogëlim të kapitalit.
 - f. Pjesëtimin e kuatave dhe anulimin e tyre.
 - g. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratës.
 - gj. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - h.. Çështje të tjera të parashikuara në ligj.
- 10.2. Ortaku i vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në pikën "1" të këtij neni pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatëse.
Të gjitha vendimet, e marra nga ortaku i vetëm rregjistrohen në regjistër të vendimeve të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.Në këtë regjistër duhet të rregjistrohen:
- a. Miratimi i pasqyrave finaciare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë.
 - b. Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve
 - c. investimet.
 - d. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 11.

Administrimi

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm emëron Administrator të Shoqërisë dhe përfaqësues ligjor të saj Z. Skifer Ponari

Skifer Ponari? *Skifer Ponari*


Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet dhe fillon nga data 06.11.2023 deri në datën 06.11.2028, me të drejtë ripërtëritje.

- 11.2. Ortaku i vetëm mund të emërojë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë pa qenë ortakë të shoqërisë. Afati i emërimit të tyre nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
- 11.3. Në se Ortaku i vetëm emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.
- 11.4. Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin (që nuk është ortak) me vendim të posaçëm.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

- a. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare.
- b. Përfaqëson shoqërinë tregëtare.
- c. Kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- d. Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të Vetëm për miratim.
- e. Kryen regjistrimin dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- f. Raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.
- h. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- i. Njofton Ortakun e Vetëm për të marë vendimet përkatëse në rastet kur bilanci vjetor, apo raportet e ndërmjetme financiare, ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim, si dhe brenda 2 vjetëve të para të regjistrimit të shoqërisë.
- j. Administratori, gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimin e shoqërisë tregëtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- k. Nëse administratori vepron në kundërtshim me detyrat dhe ligjin, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai apo çdo person tjetër i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta (në përputhje me nenin 98, pika 4 e ligjit).
- l. Në interesin e mirë të shoqërisë në teresi, administratori duhet t'i kushtojë vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedisin ku ushtron kompetencat që lidhen me ligjin dhe në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
- n. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.
- o. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent ose të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë.
- p. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.



- I. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- II. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori mund të ketë ndaj saj .

KREU IV DREJTIMI EKONOMIK

Neni 13


Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përfundimisht Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregëtar shqiptar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendit

- 14.1 Brenda 6 muaj nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Asamblesë të Ortakut të Vetëm miraton Pasqyrat Financiare të paraqitur nga Administratori. Pasqyrat Financiare përgatiten në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato mund të përgatiten edhe bazuar në Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar nëse plotësohen kriteret ligjore.
- 14.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara
- 14.2 Mbledhja e ortakut të vetëm vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jetë zbritur humbja e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.
- 14.3 Kufizimet për shpërndarjen e dividendit si dhe çertifikata e aftësisë paguese janë të zbatueshme për shoqërinë sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 77 të Ligjit nr 9091, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
 1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
 2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 14.3.1, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kriteret, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
 3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut."



4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

Neni 15

Ekspertët, Auditimi ligjor i llogarive

- 15.1 Shoqëria emëron si ekspertë, persona fizik individë apo shoqëri Auditimi, të pavarur nga shoqëria. Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregëtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetorë dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.
- 15.2 Në përfundim të kontrollit Eksperti Kontabël i Rregjistruar përgatit raportin me shkrim për kontrollet vjetore si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.
- 15.3 Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të tij kryhen në përputhje me Ligjin nr 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", por afati i caktimit të Ekspertit nuk mund të jetë më shumë se 7 vjetë kalendarike nga emërimi i parë.

Neni 16

Pasqyrat Financiare, Miratimi, Depozitimi.


- 16.1 Pasqyrat Financiare vjetore, së bashku me raportin e Audituesit të pavarur apo të shoqërisë Audituese, miratohen mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetëm, dhe depozitohen në regjistrin tregëtar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit".
- 16.2 Asambleja e përgjithshme e ortakut të vetëm jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë, fondit për investime etj.

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

- 17.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
- a) Kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) Në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregëtare;
 - d) Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare"
 - e) Në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - f) Në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - g) Për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
1. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar.



- 17.1.1 Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
- 17.1.2 Pavarësisht ngaparashikimit e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
- 17.1.3 Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
- 17.1.4 Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
- 17.1.5 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.
- 17.1.6 Në këto raste Ortaku i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënon në çdo dokument të nxjerë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëria në likuidim e sipër". Afati i emërimit të likuiditorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentin që duhet depozituar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 18

Bashkimi dhe ndarja

- 18.1 Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.
- 18.2 Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 18.3 Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen nëpërmjet shoqërive të formave të ndryshme.
- 18.4 Bashkimi ose ndarja sjell prishjen apo likuidim të shoqërisë që zhduket dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj të shoqëritë përfituese, në gjendje në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.
- Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.
- 1 Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, të cilat marrin pjesë në bashkim, hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen të paktën:
- forma, emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive që marrin pjesë në bashkim;
 - raporti i këmbimit të kuotave apo aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para;
 - kushtet e ndarjes së kuotave apo aksioneve të shoqërisë përthithëse;
 - ç) data, duke nisur nga e cila zotëruesit e këtyre kuotave apo aksioneve kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit, si dhe çdo kusht i posaçëm që ndikon në ushtrimin e kësaj të drejte;

Spencer

- d) data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse;
- dh) të drejtat që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave, aksioneve, të drejtat e veçanta apo titujt e ndryshëm nga aksionet e shoqërive të përthithura apo çdo masë tjetër e parashikuar në lidhje me ta;
- e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ë) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.
- 2 Përfaqësuesit ligjorë të secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.
 - 3 Çdo shoqëri, që merr pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt-marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen në mënyrë të detyrueshme për të paktën tri vitet e fundit.
 - 4 Shoqëritë, që përmbushin kërkesën e pikës 3, të nenit 214, të ligjit të sipër cituar, por që kanë qenë të regjistruara për më pak se tre vjet, paraqesin dokumentacionin sipas pikës 3, të këtij neni, vetëm për vitet që kanë qenë të regjistruara.
 - 5 Nëse viti i fundit ushtrimor, të cilit i referohen pasqyrat financiare, të përmendura në pikat 3 ose 4, të këtij neni, është mbyllur në një datë e cila është më e hershme se gjashtë muaj përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit, atëherë, me përjashtim të rastit kur sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", shoqëria ka hartuar dhe u ka vënë në dispozicion aksionarëve raporte financiare gjashtëmujore, shoqëria harton gjithashtu pasqyra kontabël për gjendjen e shoqërisë në një datë, e cila nuk duhet të jetë më e hershme se dita e parë e muajit të tretë përparadatës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit dhe i publikon ato sipas pikës 3 të këtij neni.
 - 6 Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri pjesëmarrëse në bashkim duhet të njoftojnë asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së tyre, si dhe organet e administrimit të shoqërive të tjera që marrin pjesë në bashkim, më qëllim njoftimin e asambleve të përgjithshme të shoqërive përkatëse në lidhje me çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet e shoqërisë, nga data në të cilën është hartuar projekt-marrëveshja e bashkimit, deri në datat e caktuara për mbledhjet e asambleve të përgjithshme që do të vendosin mbi miratimin e projekt-marrëveshjes së bashkimit.
 - 7 Detyrimi për hartimin e raportit të përmendur në pikën 2, të pasqyrave kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, të këtij neni, mund të përjashtohet me miratimin e të gjithë ortakëve/aksionarëve me të drejtë vote të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.

8

18.5 Raporti i ekspertëve

- 1 Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, caktojnë ekspertë të pavarur të

S. Parkeri

licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit. Ekspertët mund të caktohen për secilën shoqëri ose në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, që marrin pjesë në bashkim. Ata caktohen nga gjykata përkatëse, nëse kjo kërkohet nga përfaqësuesit ligjorë.

- 2 Ekspertët hartojnë një raport me shkrim, ku duhet të deklarojnë, ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm. Në deklaratë ekspertët duhet të shprehen, në veçanti:
 - a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;
 - b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;
 - c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur.
- “ç) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit.”
- 3 Ekspertët kanë të drejtë të marrin nga shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse, si dhe të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme.
- 4 Raporti i ekspertëve depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit, nëse ka, të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, në lidhje me vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit.
- 5 Përfshirja e ekspertëve, sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij neni, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive që bashkohen japin miratimin.

18.6 Miratimi i marrëveshjes së bashkimit

- 1 Projekt marrëveshja e bashkimit prodhon efekte vetëm pasi të jetë miratuar nga ortakët apo aksionarët e të gjitha shoqërive, që marrin pjesë në bashkim. Projekt marrëveshja e bashkimit miratohet, përkatësisht, në përputhje me shumicën e parashikuar në pikën 1 të nenit 87 dhe pikën 1 të nenit 145 të këtij ligji.
- 2 Kur nga projekt marrëveshja e bashkimit preken të drejtat e aksionarëve/ortakëve të veçantë apo të drejtat, që rrjedhin nga aksione të kategorive të veçanta, atëherë projekt marrëveshja i nënshtrohet, sipas rastit, miratimit të ortakëve apo aksionarëve të prekur, ose një votimi të veçantë, i cili merret me shumicën e tre të katërtave të votave të secilës kategori aksionesh të prekura.
- 3 Secili aksionar apo ortak i shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ka të drejtë të kërkojë e të marrë nga shoqëria, pa pagesë, kopje të plotë apo të pjesshme të dokumenteve, në bazë të të cilave kryhet bashkimi, sipas neneve 216 dhe 217. Nëse aksionari apo ortaku ka pranuar kryerjen e njoftimeve nga shoqëria në formë elektronike, këto dokumente mund t'i dërgohen me postë elektronike.
- 4 Shoqëria do të përjashtohet nga detyrimi për të mbajtur në dispozicion në selinë e saj dokumentacionin që duhet t'u jepet ortakëve apo aksionarëve, sipas pikës 3, nëse për një periudhë të pandërprerë, e cila nis një muaj përpara datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme për miratimin e projekt marrëveshjes së bashkimit, ky dokumentacion u vihet në dispozicion ortakëve apo aksionarëve, pa pagesë, për t'u parë, shkarkuar apo për të marrë kopje në formë shkresore në faqen e internetit të shoqërisë.

Spencer?

Për çdo ndërprerje të përkohshme të mundësisë për të hyrë në faqen e internetit të shoqërisë, për arsye teknike apo arsye të tjera, afati njëmuajor i publikimit ndërpritet dhe rinis nga e para në momentin kur faqja e internetit të shoqërisë bëhet sërish e arritshme

Neni 19

- 19.1 Shoqëria.. **PONARI 2E INVEST shpk** mund të lidhë kontrata për tregëtimin dhe shërbimet që ajo kryen ne përputhje me objektin e veprimtarisë së saj; me sektore shtetërore, drejtpërdrejt në tregun e lirë, si dhe me persona Juridike e Fizike vendas ose të huaj.

Neni 20

- 20.1 Në veprimet kontraktuale Shoqëria përfaqësohet nga Administratori i saj Z. Skifer Ponari
20.2 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata janë të detyrueshme për Shoqërinë.

Neni 21

- 21.1 Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë Bankave të vendit dhe të kryeje veprimet likujduese nëpërmjet tyre.

Neni 22

- 22.1 Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetfinancohet , të marrë hua në banka apo institute të kreditit, në lekë ose në valute të huaj. Shkëmbimin e monedhës shqiptare në monedhë të huaj dhe anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, ose në tregun e lire privat të valutes.

Neni 23

- 23.1 Për pasqyrimin e aktivitetit, administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij, janë të detyruar të mbajnë dokumentacionin e rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas kërkesave të legjislacionit.

KREU V

MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Neni 24

- 24.1 Ortaku i vetëm vendos për shtimin ose pakësimin e numrit të ortakëve dhe personave të tjerë të punësuar në veprimtarinë e Shoqërisë

Neni 25

- 25.1 Marrëdhëniet e punësimit brenda Shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis palëve, në përputhje me Legjislacionin shqiptar.

Neni 26

- 26.1 Marrja në punë bëhet nga punëdhënësi, në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës duke bërë regjistrimin në Regjistrin e të punësuarve të shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e Zyrës së Punës dhe të inspektoriatit Shtetëror në juridiksionin ku ushtron aktivitetin Shoqëria.

Neni 27

- 27.1 Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të leshuar nga administratori. Largimi lidhet me mbarimin e Kontratës së Punës, për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë **PONARI 2E INVEST shpk** do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund

Spasari?

të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi s'është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**KREU VI
TË PËRGJITHSHME**

Neni 28

Baza ligjore

28.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statusin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ;
- Kodi Civil ;
- Ligji Nr.9901 Datë.14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare ", i ndryshuar
- Ligji Nr.9228, Datë.29.4.2004, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Neni 29

Mosmarrëveshjet

29.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mundet të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 30

Dispozita Përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregëtare **PONARI 2E INVEST shpk** nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin dhe firmën në origjinale.

Neni 31

Hyrja në fuqi

31.1 Ky Statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga ortaku, sot më datë 06.11.2023

Hartuar në Tiranë, më datën 06.11.2023

Në 4 (Katër) ekzemplare sa kërkon ligji

**ASAMBLEJA E ORTAKUT TË SHOQËRISË
PONARI 2E INVEST SHPK**

Skifer Ponari

Skifer Ponari
Ponari